

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trafiku i drogës, korrupsioni dhe projekti i Kushner, seancë dëgjimore në Kongresin amerikan, DASH mbështet SPAK
ADRESA	https://lapsi.al/trafiku-i-droges-korrupsioni-dhe-projekti-i-kushner-seance-degjimore-ne-kongresin-amerikan-dash-mbeshtet-spak-i1093766
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 16:28:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:26:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	156fb3a5b0272c310b3416cda0d58ba79fddf640310c047d6dea37ff80ca7b6d
TEKSTI	b85fb37aef07315cde973f4a6e48b2c24af00cd68e9b407748e155fa9b393618
PAMJA	81ddf382163bb7546a7ffe87fdd22e235fd8ba2fc82b41824e94cc24dd04b99b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	427226384327bba20f45462305ec87bc97fc47b414f32d4b79946fb4518827f0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/427226384327bba20f45462305ec87bc97fc47b414f32d4b79946fb4518827f0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Trafiku i drogës, korrupsioni dhe projekti i Kushner, seancë dëgjimore në Kongresin amerikan, DASH mbështet SPAK



LAPSI.AL • 15 SEPTEMBER 2026



Shqipëria është përmendur në një senacë të zhvilluar në Kongresin amerikan, ku në fokus kanë qenë lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikut të narkotikëve, integriteti i zgjedhjeve, korrupsioni dhe zhvillimet politike në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë seancës, kongresmeni republikan Joe Wilson ngriti çështjen e situatës në Shqipëri, duke iu referuar raportimeve për ndikimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve të integritetit zgjedhor. Wilson pyeti administratën amerikane se çfarë po bën përballë trafikut të narkotikëve dhe rrjeteve kriminale që veprojnë në Shqipëri.

Në përgjigje, Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, Daniel Lawton, theksoi se Shtetet e Bashkuara vijnë bashkëpunimin me qeverinë shqiptare në luftën kundër organizatave kriminale transnacionale.

“Shtetet e Bashkuara po vijnë që të punojnë me qeverinë shqiptare për të luftuar organizatat kriminale transnacionale që veprojnë atje”, u shpreh Lawton.

Ai nënvizoi gjithashtu dimensionin ndërkombëtar të këtyre organizatave, duke theksuar se ato kanë lidhje me kartelet kriminale në Hemisferën Perëndimore.

Një vlerësim i veçantë në përgjigjen e zyrtarit amerikan iu dha Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK, e cila, sipas tij, ka treguar efektivitet në trajtimin e disa prej çështjeve që u ngritën gjatë seancës.

“Kemi konstatuar se struktura e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar SPAK ka qenë relativisht efektive në trajtimin e disa prej çështjeve që ju ngritët”, deklaroi Lawton.

Në vijim, zyrtari amerikan e vendosi zhvillimin e Shqipërisë në një perspektivë më të gjerë historike, duke kujtuar transformimin e vendit pas rënies së komunizmit.

ide



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

25°C

KËMBIMIEURO

91.69

aktuale

28:58

Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet

08:10



Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndique Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



“Për mua është frymëzuese të shohim që shteti më komunist gjatë Luftës së Ftohtë tani është i lirë, ndaj ne duam që Shqipëria të ketë sukses”, tha ai.

Gjatë senacës, Shqipëria u përmend edhe në kontekstin e diskutimeve për investimet dhe marrëveshjet e pasurive të paluajtshme në Ballkanin Perëndimor.

Kongresmeni demokrat Bill Keating ngriti shqetësime mbi atë që e përshkroi si përdorim të lidhjeve politike me administratën amerikane për ndjekjen e marrëveshjeve të biznesit në rajon. Në deklaratën e tij, Keating përmendi edhe Jared Kushner, dhëndrin e Presidentit Donald Trump, duke thënë se, ndërsa ai është angazhuar në çështje ndërkombëtare, ka ndjekur paralelisht projekte të rëndësishme të pasurive të paluajtshme në Serbi dhe Shqipëri.

Diskutimi në Kongres vjen në një kohë kur Shqipëria mbetet një prej vendeve të Ballkanit Perëndimor ku lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe forcimi i institucioneve të drejtësisë janë pjesë qendrore e procesit të integritetit evropian.

Në këtë kontekst, deklarata e zyrtarit të Departamentit amerikan të Shtetit për efektivitetin e SPAK përbën një element të rëndësishëm të qëndrimit amerikan ndaj institucioneve shqiptare të drejtësisë dhe bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar transnacional.

“Fatkeqësisht, ndërsa administrata Trump publikisht mbron stabilitetin rajonal, njerëz të lidhur politikisht, aktorë të jashtëm dhe miq të Presidentit po përdorin lidhjet e tyre me Shtëpinë e Bardhë për të ndjekur marrëveshje korruptive në Ballkanin Perëndimor, duke pasuruar veten dhe duke minuar sigurinë e SHBA-së. Dy shembuj të rëndësishëm lidhen me dhëndrin e Presidentit, Jared Kushner. Ndërsa Presidenti Trump e ka ngarkuar Kushnerin të negociojë globalisht me vende, përfshirë Rusinë dhe Ukrainën, ai ka ndjekur marrëveshje miliarda dollarëshe në pasuri të paluajtshme, fillimisht në Serbi dhe tani në Shqipëri”, tha Keating.

Pyetje: Kongresmeni republikan **Joe Wilson**

Ne mund të luajmë një rol në monitorimin dhe promovimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Për më tepër, është raportuar se korrupsioni, krimi i organizuar dhe integriteti zgjedhor në Shqipëri po ndikohen nga qeveria e Edi Ramës, e cila, në fakt, po nxit krijimin e një rrjeti të trafikut të narkotikëve. Ndër vite, Shtetet e Bashkuara kanë qenë vërtet të suksesshme në bashkëpunimin me autoritetet kundër krimit dhe trafikut të organizuar të drogës për ta trajtuar këtë çështje. Çfarë po bën administrata në përgjigje të trafikut të narkotikëve në Shqipëri?

Përgjigja: Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit, **Daniel Lawton**

Kongresmen Wilson, ju falënderoj gjithashtu për këtë pyetje të rëndësishme. Mund t'ju siguroj se Shtetet e Bashkuara po vijnë që të punojnë me qeverinë shqiptare për të luftuar organizatat kriminale transnacionale që veprojnë atje.

Këto organizata kanë lidhje ndërkombëtare me kartelet këtu në Hemisferën Perëndimore. Në veçanti, kemi konstatuar se struktura e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar SPAK ka qenë relativisht efektive në trajtimin e disa prej çështjeve që ju ngritët. Për mua është frymëzuese të shohim që shteti më komunist gjatë Luftës së Ftohtë tani është i lirë, ndaj ne duam që Shqipëria të ketë sukses.



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane



Del një tjetër PERGJIM i Ron Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua



Abazi-Ademi, fijet bashkohen te Balluku/ A po del në dritë skema për marrjen e Aeroportit të Vlorës?

Të këshilluara



Vendimi për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së, spitali më i madh në Kosovë merr masa paraprake

Teksa në Kosovë pritet me interes të madh vendimi i Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep ...



Rama i bën një qokë Lalit pasi gjykata e la në burg

Edi Rama ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të lënë në fuqi masën e arrestit në burg ndaj...



Zv/Ndihmës Sekretari amerikan: Po punojmë të godasim krimin transnacional në Shqipëri




Aksident i rëndë në Maqellarë-Peshkopi/ Plagosen pesë persona

Një aksident rrugor është regjistruar në aksin nacional Maqellarë-Peshkopi, ku kanë mbetur të plagosur 5 persona. Të...



Durrës/ 297 doza heroinë dhe kokainë për shitje, arrestohet 21-vjeçari

Një 21-vjeçar është arrestuar në Durrës në kuadër të operacionit antidrogë të koduar "Pikat&rdqu...



Daja i Zegjine Çaushtit përdhunon 34-vjeçaren dhe i masakron babanë, rrëfimi tronditës

U premtoi vend pune duke përdorur mbesën deputete, por më pas mori peng për 45 ditë dhe përdhunoi 34-vjeçaren në Rosk...





Makina përplashtet me këmbësorët dhe dy automjete, dy të vdekur dhe katër të plagosur rëndë në Britani



Kishte 46 precedentë dhe tentoi t'i arratisë policisë, arrestohet 64-vjeçari shqiptar në Spanjë

Autoritetet spanjolle kanë arrestuar një shqiptar, i cili kishte shumë precedentë penalë dhe me një histori të gjatë kr...



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës, GJKKO lë në burg ish-presidentin

GJKKO ka lënë në burg ish-presidentin Ilir Meta. Gjykata ka rrëzuar kërkesën për zbutje të masës së sigurisë...



I dënuar me 12 vite burg për dosjet "339" dhe "Volvo 4", arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli!

Jasin Avdyli alias Kala, i dënuar me 12 vite burg në Shqipëri në kuadër të dosjeve "339" dhe "Volvo 4", &...

Me sytë katër



28:36

PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

Një denoncim është publikuar së fundmi nga një qytetar shqiptar, i cili ndodhej në avionin me të cilin Edi Rama ka mbër...



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

16:47



"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56

SPORT

→ Të tjerë artikuj





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.